



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY

Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë

2013 – 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-B-101
Datë: 17.01.2014

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6, nenit 33 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e Strategjisë për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020


1. Miratohet Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe kërkesën me nr. ref. 3/10 2627 të dt. 22.11.2013, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DAP;
2. Divizionit për arsimin profesional;
3. Kabinetit të ministrit;
3. Zyrës së SP/MASHT;
4. Arkivit.


Prof. Dr. Ramë Buja, ministër



Përpilimi i Strategjisë është përkrahur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me mbështetje financiare nga Qeveria Novegjeze

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	5
1. Hyrje	6
2. Konteksti	7
3. Vështrim i përgjithshëm	9
4. Analiza ‘SWOT’	11
5. Strategjia	14
6. Monitorimi dhe Vlerësimi	21
7. Implementimi i strategjisë	22
8. Plani i veprimit	23

LISTA E SHKURTESAVE

PPATR	Projekti për Programet Aktive të Tregut të Punës
AAAPRR	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional për të Rritur
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CEDEFOP	Qendra Evropiane për Zhvillimin e Aftësimin Profesional
QK	Qendrat e Kompetencës
KAAPAARr	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim dhe Aftësim për të Rritur
DANIDA	Ndihma për Zhvillim Ndërkombëtar nga Danimarka
KE	Komisioni Evropian
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
BE	Bashkimi Evropian
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Bashkimit Evropian
PVB	Produkti Vendor Bruto
QeK	Qeveria e Kosovës
GIZ	Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISCED	Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimimit
RVP	Rishikim Vjetor i Përbashkët
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulumit në Kosovë
PSAK	Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë
KOSVET	Projekti për Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë (BE)
LUX-DEV	Bashkëpunimi për Zhvillim i Luksemburgut
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MeF	Ministria e Financave
KAMSH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
OJQ	Organizatë Joqeveritare
AVK	Autoriteti Vendor për Kualifikime
KVK	Korniza Vendore për Kualifikime
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OECVET	Zyra për Bashkëpunim Ekonomik dhe AAP
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
AAPT	Arsim dhe Aftësim Profesional Teknik
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional

1. HYRJE

Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë (PSAK) 2011-2016 i lidhë politikat arsimore me prioritetet kombëtare për zhvillim, duke njohur nevojën për një sistem të arsimit dhe aftësimit që i përgjigjet nevojave të tregut dhe duke theksuar nevojën për mundësi më të mëdha për të mësuar, përfshirë edhe mundësitë për praktikë profesionale të nxënësve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) nëpër ndërmarrje.

Parashihet një rol më i shtuar i ndërmarrjeve për të arritur objektivat e strategjisë dhe synimi i parë nga tetë synimet strategjike për zhvillimin e sistemit të AAP kërkon më shumë praktikë profesionale të nxënësve në bashkëpunim me ndërmarrjet.

Për të hapur udhën drejt arritjes së këtij synimi, janë krijuar disa tregues kryesor , duke përfshirë edhe zhvillimin e strategjisë për përmirësimin e praktikës profesionale, duke krijuar kritere dhe shtytje për ndërmarrjet që pranojnë nxënës në praktikë, marrëveshje që duhen nënshkruar në mes të shkollave AAP dhe ndërmarrjeve, si dhe rregullore për sigurinë dhe shëndetin për AAP.

Sipas Kornizës së re të Kurrikulumit të Kosovës (KKK), programet e praktikës profesionale janë pjesë e kurrikulumit të shkollave të mesme AAP, që janë të bazuara në rezultate të arsimit dhe nxënies së bazuar në kompetenca dhe paraqesin kornizën si vijon: klasa 10: Teori 60% kundrejt Praktikë 40%; klasa 11: Teori 50% kundrejt Praktikë 50%; klasa 12: Teori 40% kundrejt Praktikë 60%. Këto programe iu mundësojnë nxënësve të kalojnë një periudhë të planifikuar kohore nëpër ndërmarrje, ku do të fitojnë përvojë, duke i ardhur kështu në ndihmë zgjedhjeve të tyre për karrierën e mëtejme dhe duke ngritur shkathhtësitë e tyre në industri.

Shkollat e mesme AAP në Kosovë ofrojnë dy lloje kryesore të programeve të nxënies të bazuara në punë – nxënia e bazuar në punë në shkollat AAP që kanë punishtet e tyre dhe praktikë profesionale nëpër ndërmarrje. Nxënësit e AAP në përgjithësi dërgohen në ndërmarrjet që zgjedhin vet, ku do të pasqyrohet lloji i punës që ata planifikojnë të bëjnë pas përfundimit të studimeve. Për shumicën e nxënësve të AAP praktika profesionale është përvoja e parë e punës.

Koncepti i praktikës profesionale mbështetet në gjashtë dimensionet që janë kryesore sa i përket asaj se si individët mësojnë përmes punës:

- a) Qëllimi i praktikës profesionale;
- b) Supozimet lidhur me të nxënësit dhe zhvillimin;
- c) Përmbajtja e praktikës profesionale;
- d) Menaxhimi i praktikës profesionale;
- e) Rolet e mësuesve të AAP dhe tutorët në ndërmarrjet pranuese;
- f) Rezultati i praktikës profesionale.

Praktika profesionale nëpër ndërmarrje ofron një mjedis të fortë dhe me cilësi të lartë të të nxënësit ku nxënësit kanë mundësi të përfitojnë shkathhtësi praktike me pajisje moderne dhe nën kujdesin e trajnerëve që njohin shumicën e metodave dhe teknologjive më të fundit të punës.

Kështu, përkrahja zhvillimit të një partneriteti prej të cilit përfitojnë dhe gjejnë përkrahje si shkollat AAP ashtu dhe bizneset me qëllim të përmirësimit dhe përforcimit të shkathhtësive të nxënësve dhe për të plotësuar kurrikulumin në shkollë me përvoja përkatëse të të nxënësit në

ndërmarrje, duhet të jetë një shtyllë kryesore e reformës së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë.

2. KONTEKSTI

Shkalla dhe karakteri i programeve të praktikës profesionale për nxënësit e AAP në Kosovë ndikohet edhe nga një sërë faktorësh ekonomikë, demografikë, të tregut të punës, edukativë dhe kulturorë.

Sipas Ministrisë së Financave (MeF) rritja reale mesatare e Produktit Vendor Bruto (PVB) në Kosovë në vitet 2006-2009 ka qenë 4.8%. Dëshmitë tregojnë se vendimi i Qeverisë së Kosovës (QeK) për të rritur nivelin e investimeve publike me më shumë se 120% në vitin 2008 ka qenë një nga shtytësit kryesorë të zhvillimit ekonomik. Për më tepër, kjo lëvizje në burimet e alokuara për investim publik ka dëshmuar të jetë një nxitje në kohën e duhur për ekonominë në vitin 2009 dhe e ka ruajtur aftësinë të gjenerojë prej rreth 4%, në kohën kur shumica e vendeve të rajonit u përballën me recesionin ekonomik.

Për shkak të nivelit relativisht të ulët të integritit të Kosovës në ekonominë globale dhe politikave të dobëta fiskale, ekonomia e saj ishte mjaft e mbrojtur nga kriza globale ekonomike. Ajo u rrit në vitin 2009 dhe vazhdoi rritjen në vitin 2010. Rritja ekonomike ka qenë mjaft e shtytur nga shpenzimet qeveritare, ndërkohë që mosbalanca e tregtisë së jashtme vazhdoi të mbetet e madhe (Raporti i Progresit për Kosovën 2010 i KE). Në bazë të raporteve nga Banka Botërore, shumica e progresit ekonomik në periudhën e fundit ka ardhur në bazë të ndihmës nga donatorët dhe remitancave, që nuk mund të jenë baza e një strategjie të qëndrueshme ekonomike.

KAMSH 2012-2014 tregon hapësirën e limituar fiskale në Kosovë. Buxheti total i të ardhurave në fund të vitit 2014 pritet të arrijë një total prej € 1.444 milionë, ose të jetë rreth 27% më i lartë se në vitin 2010. Shpenzimet totale gjatë periudhës 2012-2013 pritet të rriten vazhdimisht, duke arritur një vlerë prej € 1.487 milionë gjatë vitit 2013, ose një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2011. Në anën tjetër, parashikimet sugjerojnë se gjatë vitit 2014 buxheti i përgjithshëm i shpenzimeve pritet të shënojë një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2013, për t'u kthyer sërish në nivel të ngjashëm me shpenzimet e projektuara në vitin 2011. Ndaj, kjo sugjeron se hapësira fiskale për shpenzime të reja si nxitje fiskale apo financiare për praktikë profesionale nëpër ndërmarrje pranuese është e kufizuar, të paktën në afat të shkurtër apo të mesëm.

Sipas të dhënave më të fundit nga Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, shpërndarja sektoriale ka mbetur stabile me kalimin e kohës. Rreth 43% e të gjitha bizneseve aktive funksionojnë në sektorin e tregtisë që karakterizohet nga investime të ulëta dhe jo produktive, që kufizojnë kapacitetin e sektorit të NVM-ve të gjenerojnë vende pune. Sa i përket ndarjes së sektorit, NVM-të më shumë janë të përqendruara në: tregëti (rreth 43%); transport, magazinim dhe shpërndarje (12%); hotele dhe restorante (9%); ndërtim (7%). Kjo strukturë e ekonomisë së Kosovës me një sektor të prodhimit rreth 10%, kufizon mundësitë për organizimin e praktikës profesionale në një shkallë të gjerë të profileve industriale.

Ekzistenca e një numri shumë të madh të mikrondërmarrjeve është një tjetër faktor me implikime për praktikën profesionale në Kosovë. Sipas Strategjisë për Zhvillimin e NVM-ve në Kosovë, ata që punësojnë më pak se nëntë vetë përbëjnë rreth 98% të të gjitha ndërmarrjeve dhe rreth 80% të të gjithë punësitë në sektorin privat. Gjithashtu, Bizneset Individuale qartazi e dominojnë strukturën e pronësisë me 90% të totalit të bizneseve të

regjistruara. Kjo kufizon rëndë numrin e vendeve për praktikë profesionale që mund të ofrohen nga një ndërmarrje dhe për rrjedhojë rrezikojnë cilësinë e trajnimit për shkak të kapacitetit të kufizuar monitorues nga instruktorë profesionalë.

Kosova po përjeton një shkallë të ulët të punësimit dhe ka sektor të madh informal. Sipas raportit mbi 'Programin e Qeverisë për Parandalimin e Ekonomisë Informale në Kosovë 2010-2012', madhësia e vlerësuar e ekonomisë informale sillet nga 39-50% të PVB. Një shkallë kaq e lartë e bizneseve të peregjistruara është faktor me rëndësi që kufizon numrin e vendeve potenciale për praktikë profesionale për nxënës të AAP.

Vendi ka popullsinë më të re në rajon dhe kjo popullsi vazhdon të rritet shumë më shpejt se në Evropë (+0.6% pothuajse konstante). Rreth 28% e popullsisë është më e re se 15 vjeç, gati dy të tretat (65%) i përkasin grupmoshës 15-64 vjeç (që njihet si ekonomikisht aktive) dhe pjesa tjetër 7% janë më të vjetër se 65 vjeç (ASK, 2010). Ky fakt shkakton mjaft presion ndaj QeK për të gjetur punë, arsim dhe aftësim për të rinjtë.

Me një shkallë të papunësisë prej 45% dhe shkallë shumë të ulët të punësimit (28%), Kosova ka profilin më të dobët në Evropë sa i përket punësimit dhe shkalla e pjesëmarrjes prej 48% në mesin e popullsisë në moshë pune është dukshëm nën mesatare në mesin e të gjitha ekonomive në tranzicion (ASK, 2009). Më shumë se 93.8% e të papunësuarve të regjistruar, janë të papunësuar afatgjatë dhe rreth 48.6% e tyre janë gra. Rreth 60% e të papunësuarve të regjistruar i referohen nivelit arsimor "të pakualifikuar" dhe më shumë se 72 % e të gjithë të papunësuarve të regjistruar kanë nivel arsimor nën shkollën e mesme (MPMS, 2012). Grupmosha më e re, nga 15-24 vjet, përballet me shkallën më të lartë të papunësisë në 73% (ASK, 2009), dhe me prurjen më të madhe në papunësi me 0.7%.

Proporcioni i njerëzve me moshë 15 vjeç ose më shumë, që kanë kryer të paktën nivelin e shkollës së mesme, ka qenë 37.8% në vitin 2009, me një ndarje të madhe gjinore (meshkuj: 47.3% në vitin 2009 dhe femrat vetëm 28.3% me këtë nivel të arsimit në vitin 2009). Arritjet arsimore paraqesin dhe dallime të mëdha në aspektin urban/rural: përafërsisht 50% e fëmijëve ruralë ndjekin shkollën e mesme në krahasim me më shumë se 70% nga zonat urbane, me një dallim të dukshëm gjinor (meshkuj: 56% dhe femra: 44% të nxënësve).

Në Kosovë, problem të madh përbën edhe largimi i hershëm nga shkolla. Dy nga tre të rinj largohen nga sistemi arsimor pa ndonjë kualifikim (ETF, 2008). Nga fundi i vitit shkollor 2009/2010, përqindja e nxënësve që u larguan nga i gjithë sistemi i shkollave të mesme ka qenë 2.98%, ku 81.12% ishin nga drejtimet profesionale (ASK, 2011). Një studim i kohëve të fundit ka gjetur se ata që heqin dorë nga mundësitë për arsim sfidohen me vështirësi për të pasur qasje në aftësime/kurse plotësuese ose profesionale dhe vështirësitë më të mëdha janë vërejtur në mesin e grave rurale dhe më të varfra (UNDP, 2012). Një tjetër studim raporton se komuniteti RAE ka tendencën më të madhe për t'u larguar nga shkolla, me shkallë edhe më të lartë në mesin e vajzave RAE (RIINVEST, 2009). Mungesa e mjeteve financiare/varfëria dhe nevoja për të gjetur punë janë raportuar si faktorët kryesorë për largimin nga shkolla në mesin e nxënësve AAP.

Me PVB për kokë banori prej €1,850, Kosova është një nga vendet më të varfra në Europë. Varfëria nuk luhet dhe vazhdon të rritet: sipas të dhënave më të fundit në dispozicion (viti 2007), 45% e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë nacionale dhe rreth 17% janë skajshmërisht të varfër, d.m.th., nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat bazë për ushqim. (Banka Botërore, 2010). Gjetjet nga hulumtimi raportojnë se të rinjtë 15-25 vjeçarë në Kosovë përbëjnë 21.4% të popullsisë, shumica janë të pamartuar dhe jetojnë në shtëpi me më shumë

se 6 anëtarë (ILO, YEP 2006). Vlerësohet se mes 20-30% e nxënësve AAP vijnë nga familje që janë përfitues të ndihmës sociale dhe nuk marrin pjesë në praktikën profesionale, nëse ka, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Faktorët kulturorë si stereotipet gjinore dhe roli i familjes, ndikojnë në atraktivitetin e arsimit dhe aftësimin profesional për gratë. Përfaqësimi i tyre në tregun e punës ende mbetet shumë i ulët (28,7%) dhe më pak se gjysma e atyre që janë punësuar (12%) punojnë me kontrata me orar të plotë (ESK - AFP, 2009). Mosprania ose ngurrimi i grave për të hyrë në tregun e punës ose për t'u larguar nga shkolla shpjegohet nga një sërë faktorësh: “së pari, për arsye familjare dhe të obligimeve në shtëpi dhe, së dyti, sipas të gjitha gjasave, ato dekurajohen më lehtë, sepse të jesh femër dhe me nivel të ulët të aftësimin, shanset për të gjetur punë janë shumë të vogla ” (ETF, Raporti i Procesit 2012 Torino). Fusha teknike raportohet të jetë fushë që në mënyrë tipike dominohet nga meshkujt ku gratë përbëjnë vetëm rreth 28% të grupit të nxënësve dhe kryesisht në rajonin e Prishtinës (Korniza e Programit për Barazi Gjinore 2008-2013). Situata është edhe më shqetësuese në rajone të tjera.

3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Nën-sektori për Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë është pjesë e nivelit të shkollës së mesme (ISCED 3) dhe i shërben grupmoshës 15-18 vjeç. Këta nxënës janë të shpërndarë në 59 shkolla të përgjithshme AAP dhe në 2 shkolla të tjera të specializuara AAP (Qendra të Kompetencës), që funksionojnë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtorive Komunale për Arsim. Këto shkolla të AAP janë të shpërndara në 26 qytetet kryesore të Kosovës dhe janë të sistematizuara në 6 rajonet kryesore. Sipas llojit të tyre shkollat janë ndarë në: teknike (19), të përziera (9), ekonomike (10), mjekësore (7), artistike (2 shkolla arti dhe 7 shkolla muzikore), bujqësore (3), hoteleri-turizëm (1), teologji (1) dhe Qendrat e Kompetencës (1 qendër për Ndërtimtari dhe 1 qendër për Ekonomi, Administratë dhe Tregti). Numri total i nxënësve që kanë ndjekur shkollat profesionale gjatë vitit shkollor 2011/12 ka qenë mbi 59.600 nxënës, që përfaqësojnë 56% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të nivelit të shkollës së mesme të lartë. Vlerësohet se ka 17 lëmi profesionale dhe 90 profile, 60 kualifikime modulare dhe 20 standarde pune që janë zhvilluar deri më tani.

Raporti i ETF për Procesin e Torinos 2012 tregon se pavarësisht problemeve me çështje organizative dhe praktike të praktikës profesionale për nxënës të shkollave profesionale, të dhënat nxjerrin probleme të tjera. Një studim i kryer nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në vitin 2011 raporton se:

- (i) 18 % e shkollave profesionale nuk ofrojnë nxënie të bazuar në praktikë për shkak të mungesës së infrastrukturës/punëtorive dhe mungesës së mekanizmave për të arritur bashkëpunimin me ndërmarrjet që mund të akomodojnë një numër të caktuar të nxënësve si pjesë e orëve të praktikës;
- (ii) 54% arrijnë të ofrojnë mësimnxënie të mbështetur në praktikë duke i dërguar nxënësit nëpër ndërmarrje, ndërsa
- (iii) 43% e shkollave ofrojnë praktikë profesionale në shkollë pasi kanë pajisur tërësisht punëtoritë dhe rrallëherë kanë nevojë që nxënësit t'i dërgojnë nëpër ndërmarrje.

Përqindja e nxënësve që nuk kalojnë nëpër asnjë lloj praktike është relativisht e lartë dhe është raportuar se është rreth 40% e të gjithë nxënësve të AAP. Si rezultat i drejtëpërdrejtë i kësaj, këta nxënës do të hyjnë në tregun e punës si të paaftësuar ose pak të aftësuar, duke patur

kështu perspektivë shumë të ulët për të gjetur punësim dhe, për rrjedhojë, do të bien në kurthin e varfërisë.

Sfidat

Faktorët ekonomik dhe demografik janë identifikuar si arsyet kryesore për mungesën e vendeve për praktikë profesionale në Kosovë. Për më tepër, ka edhe faktorë të tjerë strukturorë afatgjatë që kanë ndikim të madh, si për shembull:

- a) Rënia dramatike në numrin e vendeve për praktikë profesionale nëpër ndërmarrje të mëdha për shkak të numrit të ulët të ndërmarrjeve të tilla;
- b) Sa i përket zanateve, që nga aspekti numerik janë më të rëndësishme sa i përket ofrimit të praktikës profesionale, ndërmarrjet gjithnjë e më shumë nuk janë në gjendje të ofrojnë trajnim (aftësim) dhe përvojë për atë shumëllojshmëri detyrash dhe njohurish që kërkohen nga profilet e reja të punëve;
- c) Rritja e sektorit terciar të ekonomisë nuk është shoqëruar nga ndonjë rritje korresponduese në vende të praktikës profesionale në shërbim dhe në infrastrukturën e vendeve të punës.

Praktika e mirë

Më poshtë janë renditur disa përvoja të suksesshme gjatë aplikimit të praktikës profesionale. Këto janë parakushte për nxënësit e AAP që të nxjerrin më të mirën:

- a) Qëllimi i qartë, synimet dhe objektivat që janë diskutuar dhe janë arritur mes nxënësit të AAP, shkollës AAP dhe punëdhënësit;
- b) Planifikimi dhe përgatitja për të siguruar se të gjitha palët e kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre, përfshirë edhe prezantimin orientues në momentin kur nxënësit e AAP fillojnë praktikën në vendin e punës;
- c) Të sigurohet se nxënësit e AAP kanë aftësi praktike bazë që përputhen me fushën e aktivitetit të kompanisë si dhe të njoftohen punëdhënësit para nënshkrimit të marrëveshjes.
- d) Përputhja e nxënësve APP, secilit individualisht, me vende të përshtatshme sipas interesave dhe nevojave të tyre dhe duke pasur parasysh për çfarë përkrahjeje ata mund të kenë nevojë derisa janë në atë vend të punës;
- e) Monitorimi dhe rishikimi gjatë dhe pas vendosjes në ndërmarrje për t'i ndihmuar nxënësit e AAP të vënë në përdorim atë që kanë mësuar.

Parimet udhëheqëse për shkollat AAP

- a) Shkollat AAP kanë përgjegjësi të organizojnë praktikën profesionale për nxënësit e tyre;
- b) Shkollat AAP duhet të sigurojnë se ndërmarrjet kanë mjedise të mjaftueshme dhe potencial për nxënie dhe kanë personel që të udhëheqin nxënësit e tyre;
- c) Shkollat AAP duhet ta trajnojnë personelin e ndërmarrjes dhe të organizojnë programe trajnuese për t'u siguruar që stafi i kupton objektivat e programit për praktikë profesionale;
- d) Shkollat AAP duhet të bëjnë marrëveshje formale me ndërmarrjet, përfshirë oraret, përkufizimin e objektivave të nxënies, përmbajtjen e kurrikulumit, sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Ato duhet të emërojnë edhe instruktorët në vendin e punës dhe të praktikës për të koordinuar programin dhe
- e) Shkollat AAP kanë përgjegjësi të vlerësojnë rezultatet e programit të praktikës profesionale.

4. ANALIZA ‘SWOT’

Analiza ‘SWOT’ është një teknikë e dobishme për të kuptuar Përparësitë dhe Dobësitë në organizimin e praktikës profesionale nëpër ndërmarrje dhe për të identifikuar Mundësitë që kanë shkollat AAP dhe Kërcënimet me të cilat ato përballen. Kjo teknikë nënkupton analizë të të gjithë faktorëve të brendshëm dhe të atyre të jashtëm.

Analiza e faktorëve të brendshëm si *përparësitë dhe dobësitë* në përgjithësi bazohet në komponentët kryesorë të partneriteteve mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve: Njerëzit, Burimet, Risitë, Marketingu, Udhëheqja dhe Financat.

Analiza e faktorëve të jashtëm si *mundësitë dhe kërcënimet*, në përgjithësi bazohet në trende Politike, Ekonomike, Sociale dhe Teknologjike, në opcionet dhe mundësitë për zhvillim.

Analiza ‘SWOT’ është prodhuar gjatë një seance diskutimesh dhe është diskutuar dhe është rënë dakord për të në një punëtori me grupin punues. Para saj, janë zhvilluar disa intervista të strukturuar dhe fokus grupe me palë të ndryshme të interesit dhe janë shqyrtuar një sërë dokumentesh strategjike, raporte strategjike dhe korniza ligjore, të gjitha të përfshira në një raport vlerësimi.

PËRPARËSITË

Përparësitë iu referohen aftësive që mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të praktikës profesionale në ndërmarrje. Ato janë shumë të rëndësishme, sepse përparësitë mund të përdoren për të shfrytëzuar mundësitë, të merren me dobësitë dhe të shmangin kërcënimet. Në kontekst të zhvillimit të praktikës profesionale në Kosovë, janë identifikuar 9 përparësi:

- S1. Mësimdhënësit e AAP azhurnojnë njohuritë dhe shkathhtësitë e tyre nga bashkëpunimi dhe komunikimi me punëtorë të kualifikuar;
- S2. Nxënësit që marrin pjesë në praktikë profesionale janë më të motivuar dhe më të interesuar gjatë trajnimit në klasë.
- S3. Të dhënat statistikore tregojnë disa përmirësime në pjesëmarrjen e nxënësve të AAP që vijnë nga grupe të rrezikuara ;
- S4. Nxënësit që marrin pjesë në praktikë profesionale janë punësuar nga ndërmarrjet pranuese;
- S5. Përmirësim i dukshëm i menaxhimit të shkollave AAP, mësimdhënies, mjediseve dhe zhvillimit të materialit;
- S6. Shumica e shkollave AAP kanë traditë dhe reputacion të mirë në komunitet;
- S7. Qendrat e Kompetencës po ndihmojnë të rrisin atraktivitetin dhe prestigjin e AAP;
- S8. Më shumë se gjysma e shkollave AAP arrijnë të organizojnë vet praktikën profesionale nëpër ndërmarrje;
- S9. Shkollat AAP, që kanë organizuar praktikë profesionale, raportojnë bashkëpunim të mirë me ndërmarrjet.

DOBËSITË

Dobësitë janë elementet që e pengojnë zbatimin e sistemit të praktikës profesionale në mënyrë të shëndoshë. Dobësitë janë gjithashtu faktorë që nuk plotësojnë standardet e kërkuara të kurikulimit dhe përkeqësojnë suksesin e shkollave AAP dhe rritjen e tyre. Në total, janë identifikuar 10 dobësi për praktikën profesionale në Kosovë:

- W1. Drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave AAP nuk kanë shkathtësitë thelbësore menaxheriale për të themeluar partneritete efektive mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve;
- W2. Vullneti i ulët i drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave AAP për shkak të pagave të ulëta dhe shpenzimeve shtesë për udhëtim, reflekton në kryerjen e detyrave të tyre gjatë praktikës profesionale;
- W3. Për arsye të ndryshme, një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk marrin pjesë në praktikën profesionale;
- W4. Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave AAP nga grupet e rrezikuara është e pakënaqshme, janë larg proporcioneve korresponduese në popullsinë me moshë pune;
- W5. Shkollave AAP u mungojnë materiale promovuese për të përforcuar mesazhin e tyre kur takohen me punëdhënës për të krijuar partneritete të reja;
- W6. Nuk ka vizion të qartë se kush është përgjegjës, kush mund të ofrojë përkrahje dhe si duhet të organizohet praktika profesionale;
- W7. Programet e praktikës profesionale nuk janë hartuar përmes partneriteteve të vërteta punuese mes shkollave AAP dhe punëdhënësve;
- W8. Trajnimi për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës trajtohen shkarazi;
- W9. Nuk duket që politikat për mbrojtjen e fëmijëve të jenë me rëndësi të lartë për shkollat AAP;
- W10. Pjesëmarrje e ulët e shkollave AAP në programe të komunitetit.

MUNDËSITË

Mundësitë janë shanset për të përmirësuar performancën gjatë organizimit të praktikës profesionale. Këto prezantohen nga përfshirja e përgjithshme e mjedisit të jashtëm, brenda të cilit organizohet praktika profesionale. Grupi punues ka identifikuar një numër prej 12 mundësishë:

- O1. Pjesëmarrje më e lartë e partnerëve socialë në procese të politikës AAP;
- O2. Përfshirja e punëdhënësve në identifikimin e nevojave për aftësim dhe formulimin e propozimeve për përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional;
- O3. Kërkesat në rritje të punëdhënësve për punëtorë të kualifikuar në nivel të “shkollës së mesme”;
- O4. Rritja e kërkesës për punëtorë në miniera, ndërtim, mbrojtje shëndetësore/shoqërore, shërbime dhe OJQ/organizata ndërkombëtare;
- O5. Ndërmarrjet kanë pajisje, materiale dhe mjete më të reja;
- O6. Ish-nxënës të AAP ofrojnë përkrahje për praktikë profesionale për shkollat dhe punëdhënësit e tyre;
- O7. Nga donatorët pritet të rrisin përkrahjen e tyre për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, ngritjen e kapaciteteve dhe arsimin për të rritur;
- O8. Metodat e reja për të lidhur shkollat AAP me ndërmarrjet që implementohen në kontekst të projekteve të financuara nga donatorët, rrisin pjesëmarrjen e punëdhënësve dhe cilësinë e aftësimin;
- O9. Zhvillohen Udhëzues, Doracakë ose Paketa Udhëzimesh brenda kontekstit të projekteve të financuara nga donatorë që përmirësojnë kapacitetin e drejtorëve dhe të mësimdhënësve të shkollave AAP për të krijuar partneritete të suksesshme me punëdhënësit;
- O10. Ndërmarrjeve iu ofrohen nxitje financiare në kontekst të projekteve të financuara nga donatorë që rrisin numrin e mundësive për praktika profesionale;

- O11. Nxitjet financiare që sigurohen për nxënës të AAP në kontekst të projekteve të financuara nga donatorë rrisin shkallën e pjesëmarrjes së tyre në praktikat profesionale nëpër ndërmarrje;
- O12. Studimet bazë të kryera për disa profile tregojnë se rreth 46% e ndërmarrjeve të intervistuarra janë të gatshme të bashkëfinancojnë sistemin AAP.

KËRCËNIMET

Këto janë ndryshime në mjedisin e jashtëm që mund të kenë ndikim negativ për organizimin e praktikave profesionale nëpër ndërmarrje. Për më tepër, këto mund të jenë cilatdo rrethana të jashtme ose trende që ndikojnë në mënyrë të pafavorshme tek organizimi i praktikës profesionale. Gjatë analizës ‘SWOT’ janë identifikuar 19 kërcënime:

- T1. Sistemi AAP nuk është fleksibil dhe nuk lejon sasi të mjaftueshme për autonomi lokale dhe inovacion për të përshtatur praktikën profesionale me rrethanat lokale;
- T2. Mospërputhja në mes të strukturës së ekonomisë lokale dhe profileve të shkollave AAP për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në dhjetë vitet e fundit;
- T3. Mospërputhja në mes të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës dhe papunësia e lartë, sidomos në mesin e të rinjve;
- T4. Mikrondërmarrjet vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të ndërmarrjeve në Kosovë, duke kufizuar kështu numrin e nxënësve nga AAP që vendosen në secilën ndërmarrje;
- T5. Mundësitë për praktikë profesionale dhe punësim në zonat rurale janë shumë të kufizuara;
- T6. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë dhe që po rritet shumë shpejt;
- T7. Perceptimi i gabuar se nxënësit e AAP nuk kanë ambicie;
- T8. Numri në rritje i nxënësve nga familje që janë përfitues të skemës së asistencës sociale;
- T9. Shpenzimet për udhëtim për të marrë pjesë në praktikë profesionale në ndërmarrje që gjenden jashtë komunës shtojnë shpenzimet familjare për shkollimin e fëmijëve të tyre;
- T10. Partneritetet lokale për arsim dhe/ose punësim nuk ekzistojnë ose eventualisht janë në faza shumë të hershme, që privojnë shkollat AAP nga përkrahja për të cilën kanë aq shumë nevojë;
- T11. Sigurimi i vendeve për praktikë profesionale nuk është atraktiv për punëdhënësit;
- T12. Punëdhënësit kanë raportuar se shkollat AAP nuk i pajisin nxënësit me kualifikimet që nevojiten;
- T13. Shpërfillja e zotimeve në marrëveshje të nënshkruara nga shkollat AAP dhe punëdhënësit;
- T14. Numri i kufizuar i nxënësve që mund të caktohen të kryejnë praktikën profesionale në një ndërmarrje;
- T15. Numër i pamjaftueshëm i punëdhënësve që ofrojnë mundësi për praktikë profesionale;
- T16. Trajnimi për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës ende nuk është bërë pjesë e kulturës dhe e praktikës së biznesit në Kosovë;
- T17. Dokumentacioni dhe burokracia shihen si pengesë kryesore nga punëdhënësit;
- T18. Mungesa e nxitjeve (ligjore, financiare ose motivuese) për punëdhënësit nuk i inkurajon ata të ofrojnë mundësi për praktikë profesionale;
- T19. Donatorët janë duke zvogëluar nivelin e përkrahjes për aftësimin profesional.

5. STRATEGJIA PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE NË KOSOVË

Misioni ynë

Të përkrahim zhvillimin e një partneriteti mes shkollave AAP dhe bizneseve, nga i cili të përfitojnë dhe të kenë përkrahje të dyja palët, me qëllim të zgjerimit të njohurive dhe të shkathtësive të nxënësve të AAP brenda një mjedisi praktik, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për punësim produktiv dhe nxënie të mëtijshme.

Vizioni ynë

Sistemi për Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë aspiron të ketë një praktikë profesionale me cilësi të lartë të bazuar në kompetenca që mbështet rritjen e biznesit dhe jep për të gjithë nxënësit njohurinë dhe shkathtësitë për të cilat ata kanë nevojë në një mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm pune.

Parimet që na udhëheqin

- Që aktivitetet e praktikës profesionale që përfshijnë shkollat AAP dhe bizneset, të kontribuojnë në nevojat lokale dhe nacionale për shkathtësi.
- Të gjithë nxënësit të kenë mundësinë të rrisin njohuritë dhe shkathtësitë e tyre përmes pjesëmarrjes në praktikë profesionale.
- Shkollat AAP dhe bizneset të përkufizojnë qartë përfitimet që dëshirojnë të arrijnë përmes praktikës profesionale.
- Të gjitha aktivitetet të kenë objektiva të qarta sipas kurrikulumit të nxënies për nxënësit pjesëmarrës dhe gjithçka të monitorohet, vlerësohet dhe regjistrohet.
- Të jenë ndërmarrë të gjitha masat për kujdesin e shëndetit dhe sigurinë në punë dhe që çështjet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, të respektohen gjatë aktiviteteve të praktikës profesionale.

Strategjia jonë

Plani ynë strategjik paraqet një skicë të qartë për të ardhmen e praktikës profesionale në Kosovë. Në thelb, plani paraqet rrugën drejt ndërtimit të përvojës së praktikës profesionale të cilësisë së lartë për të gjithë nxënësit e shkollave për Aftësim dhe Arsim Profesional (AAP). Ai paraqet drejtimin e fokusuar tek ndarja e njohurisë, përkrahja e përfundimit të shkathtësive të kërkuara për të themeluar partneritete të suksesshme mes shkollave dhe ndërmarrjeve dhe trajtimi i barrierave, me të cilat përballen të gjitha palët e përfshira përmes zhvillimit të kornizës së duhur të bashkëpunimit.

PRIORITETI STRATEGJIK 1

Rritja e numrit të punëdhënësve që ofrojnë vende/mundësi për praktikë profesionale

Gjatë shqyrtimit të të gjitha ndërhyrjeve të politikave për të përkrahur shkollat AAP në zgjerimin e natyrës dhe të përmasave së praktikës profesionale, duhen pasur parasysh edhe çështjet e ndërlidhura me punëdhënësit. Sfidat këtu përfshijnë motivimin e punëdhënësve dhe

punëmarrësve individualë për të parë vlerën dhe për t'u angazhuar në praktikë profesionale. Orientimi i më shumë energjive dhe përpjekjeve drejt ndarjes së informacionit, thjeshtimit të procedurave, sigurimit të mekanizmave stimulues tërheqës dhe të qëndrueshëm, së bashku me instrumente dhe ngjarje të njohjes publike, mundësojnë një qasje më pozitive të punëdhënësve ndaj praktikës profesionale.

MASAT

1.1 Lehtësime për punëdhënësit të marrin përsipër praktikën profesionale duke iu prezantuar materiale udhëzuese për punëdhënësit dhe duke thjeshtësuar procesin;

Organizimi i periudhave të praktikës profesionale është një detyrë që kërkon shumë energji. Jo vetëm që është një detyrë e vështirë, pasi edhe në një ekonomi të fortë dhe të shëndetshme nuk është e lehtë të gjenden punëdhënësit të gatshëm që ofrojnë vende për praktikë, por është edhe problem i madh të sigurohet që periudha e praktikës të jetë e suksesshme. Prandaj, për të larguar pengesat me të cilat përballen punëdhënësit, ekziston nevoja që atyre t'u jepet informacion i qartë, i hollësishëm dhe i strukturuar mirë për çdo hap të procesit të praktikës profesionale. Informacioni i tillë i strukturuar mund të paraqitet në formën e një "Doracakut për Punëdhënësit" që të vihet në dispozicion të të gjithë punëdhënësve që janë të gatshëm të arrijnë marrëveshje profesionale me ndonjë shkollë të AAP. Gjithashtu, ai duhet të shoqërohet edhe me një sërë instrumentesh të përdorshëm, që ndryshe quhen "Paketa e Punëdhënësve", që përmbajnë disa lista kontrolli, formularë, shabllonë etj., për t'iu ndihmuar atyre të ecin nëpër procesin e praktikës profesionale.

1.2 Përkrahje për punëdhënësit që të marrin nxënës të AAP për praktikë profesionale përmes mekanizmave të duhur nxitës;

Procesi i praktikës profesionale përfshinë mjaft shpenzime për ndërmarrjen pritëse, si koha për mbikëqyrjen e stafit, materialet bruto dhe ndoshta mjete/pajisje shtesë ose veshje personale mbrojtëse dhe pajisje. Ndërmarrjet më të vogla, që përbëjnë dhe shumicën dërmuese të ndërmarrjeve në Kosovë, kanë pritshmëri që përpjekjet e tyre për të qenë nikoqirë të praktikës profesionale të njihen dhe të përkrahen nga Qeveria.

Prandaj, duhet zhvilluar një analizë e kujdesshme dhe e hollësishme për të përkrahur zhvillimin e një sërë nxitësish të duhur (fiskalë, financiarë ose jo-financiarë) në bazë të ushtrimit të modelit financiar të përshtatshëm. Hapi i parë në këtë drejtim është bërë përmes dispozitës mundësuese të nenit 33, paragrafi 3 të Ligjit të ri për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, që sugjeron uljen e taksave për ndërmarrjen nikoqire si nxitës të përshtatshëm

1.3 Promovimi i njohjes, vlerës dhe punës së punëdhënësve të cilët kanë ofruar mundësi për praktikë profesionale;

Përfshirja e punëdhënësve në sistemin e AAP luan një rol qendror për zhvillimin e praktikës profesionale me nivel të lartë të bazuar në kompetenca, që synon të përputhë nevojat e tregut të punës dhe t'i sigurojë Kosovës fuqi punëtore shumë të aftësuar. Pa kontributin e tyre, të diplomuarit nga shkollat e AAP nuk do të ishin të përgatitur për punësim produktiv apo mësimnxënie të vazhdueshme.

Kjo është edhe arsyeja pse përkrahja e tyre është po aq e rëndësishme sa edhe puna e mësimdhënësve dhe e instruktorëve nëpër shkolla. Prandaj, nevojitet një Program Vlerësimi për Punëdhënësit për të njohur publikisht rëndësinë e punëdhënësve që përkrahin praktikën

profesionale të nxënësve të AAP duke ofruar vende të përshtatshme dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale. Një program i tillë mund të rrisë motivimin e ndërmarrjes nikoqire në fjalë për të vazhduar, por edhe mund të frymëzojë ndërmarrje të tjera që të përfshihen në të.

1.4 Praktika profesionale të bëhet më e kuptueshme për punëdhënësit;

Në mënyrë që punëdhënësit të ndjehen rehat me procesin e praktikës profesionale dhe për të ngritur vetëdijësimin e tyre, është e nevojshme që atyre t'iu sigurohen materiale të ndryshme promovuese që shpjegojnë shkurtimisht për ta dhe stafin e tyre konceptet e përvojës praktike. Këto materiale shpjegojnë programet e praktikës profesionale nëpër shkollat e AAP, përkrahjen për punëdhënësit dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre kur mirëpresin nxënës në vendin e tyre të punës.

Përveç kësaj, organizimi i takimeve rajonale me punëdhënësit për të avokuar nevojën e përkrahjes së praktikës profesionale mbështet edhe largimin e barrierave në komunikimin mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve. Gjithashtu, përkrahë të dyja palët për të kuptuar më mirë shqetësimet e tyre dhe për të gjetur bashkërisht zgjidhje për forcimin e bashkëpunimit.

PRIORITETI STRATEGJIK 2

Rritja e numrit të nxënësve të AAP që marrin pjesë në praktikën profesionale

Një nga synimet e praktikës profesionale është të ofrohet qasje për të gjithë nxënësit e shkollave të AAP, duke përfshirë edhe nxënësit e talentuar në aspektin akademik, ata që kanë prindër të vetëm, ata që kanë probleme shëndetësore, personat me aftësi të kufizuara, ndër ta edhe personat me vështirësi në mësimnxënie dhe/ose aftësi të kufizuara, kujdestarët e rinj, keqpërdoruesit e substancave, si dhe nxënës me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore.

Prandaj, identifikimi i nevojave të tyre specifike dhe trajtimi i tyre si duhet përmes përpjekjeve të përbashkëta të të gjitha palëve të përfshira, edhe të prindërve të tyre, do të bëjë të mundur pjesëmarrje më të madhe në praktikën profesionale.

MASAT

2.1 Të bëhet e sigurtë se praktika profesionale në tërësi i përshtatet kërkesave dhe aftësive individuale të secilit nxënës të AAP;

Të gjithë nxënësve, përfshirë dhe ata me aftësi të kufizuara, duhet t'iu sigurohet qasje në praktikën profesionale dhe të mund të përfitojnë nga ajo. Ligji në fuqi kërkon që shkollat e AAP të përgatisin nxënësit që janë me aftësi të kufizuara për arsimim të mëtejshëm, për punësim dhe për një jetë të pavarur. Prandaj, kërkohen përpjekje shtesë për të siguruar se të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara kanë qasje në kurrikulumin e përgjithshëm të arsimit, kanë arsim publik falas në nivelin e duhur që përmbush nevojat e posaçme të nxënësve dhe kanë shërbime të planifikimit të tranzicionit që t'iu ndihmojnë atyre në përgatitjen për jetë, mësim dhe punë pas përfundimit të shkollës.

Shkollat AAP duhet t'iu sigurojnë ndërmarrjeve nikoqire informacion relevant për nxënësit, për shembull për shëndetin e tyre. Ato duhet të dinë dhe t'iu njoftojnë punëdhënësit për çfarëdo faktori që mund të pritet të ndikojë në aftësinë e nxënësve të tyre për të kuptuar dhe për të reaguar ndaj informacionit dhe udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë në punë, ose për shembull të ofrojnë informacion rreth ndonjë paaftësie për të nxënë ose për probleme me gjuhën.

Në raste dhe raporte të ndryshme, janë vënë në dukje një sërë barrierash shitesë për pjesëmarrjen e nxënësve nga shkollat AAP në praktikën profesionale. Për shkak të të dhënave të pakta, pritet të bëhen analiza të tjera për të identifikuar ato elementë që ndikojnë negativisht tek rezultati i nxënësve dhe për t'i përkrahur ata të tejkalojnë barrierat specifike me të cilat mund të përballen.

2.2 Sigurimi se nxënësve të AAP të kualifikuar iu vihet në dispozicion financim shitesë;

Çështjet e sigurimit gjatë praktikës profesionale janë shqetësim si për shkollën AAP, ashtu edhe për punëdhënësin. Shqetësimet rreth sigurimit zakonisht kanë të bëjnë me lëndime të nxënësve pjesëmarrës në kantier pune ose gjatë rrugës, lëndimet që iu shkaktohen të tjerëve si dhe dëmtimet e pronës apo biznesit të punëdhënësit. Ligji aktual në fuqi në Kosovë nuk parasheh dispozita të veçanta që kanë të bëjnë me këto çështje. Për më tepër, ka mungesë të policave të sigurimit të vetë nxënësve apo sigurim për përgjegjësi nga ana e punëdhënësit. Meqë projektet aktuale të donatorëve kanë identifikuar zgjidhje të ndryshme për mbulimin me sigurim shëndetësor të nxënësve, duhet të vazhdojnë negociatat me autoritetet qendrore dhe/ose lokale për të arritur marrëveshje për mekanizmin financues më të përshtatshëm.

Për shkak të mospërputhjes mes profilit të shkollave AAP dhe strukturës ekonomike lokale në disa nga komunat, disa shkolla AAP duhet të organizojnë praktikën profesionale në ndërmarrje që gjenden jo më shumë se 20-30 km larg nga vendndodhja e shkollës. Në rrethana të jashtëzakonshme, udhëtimi mes vendndodhjes së shkollës dhe vendndodhjes së praktikës profesionale sigurohet nga ndërmarrja. Në shumicën e rasteve të tjera, shpenzimet e udhëtimit përbëjnë një tjetër barrë për familjet e nxënësve, sidomos për ato familje që janë përfituese të skemës së asistencës sociale. Prandaj, duhet bërë një analizë e hollësishme për të identifikuar shkallën e saktë të kësaj gjendjeje, për të përcaktuar qartë grupin e nxënësve që kualifikohen si dhe për të përcaktuar mekanizmin financues.

2.3 Komunikimi i përfitimeve nga praktika profesionale tek nxënësit AAP dhe prindërit e tyre;

Përmes ndërveprimit mes studimit dhe praktikës profesionale, nxënësit e AAP mund të përmirësojnë njohuritë e tyre akademike, zhvillimin personal dhe përgatitjen profesionale. Prindërit, anëtarët e familjes dhe tutorët mund t'iu ndihmojnë të rinjve të vendosin vet dhe të kenë qasje në burime që i përgatisin për karrierën e tyre.

Për fat të keq, shumë familje nuk e shohin praktikën profesionale si pjesë të përvojës shkollore. Për më tepër, disa prej tyre janë të shqetësuar nga mjedisi potencialisht i dëmshëm në vendin e punës, ndërsa të tjerë shqetësohen për ekspozimin e fëmijëve të tyre ndaj abuzimit fizik ose verbal.

Prandaj, është me rëndësi që prindërve dhe familjeve t'u japim informacion të duhur dhe përkrahjen e nevojshme që të lejojnë, inkurajojnë dhe ndihmojnë fëmijët e tyre të zhvillohen, të mësojnë dhe të marrin pjesë në praktikën profesionale.

PRIORITETI STRATEGJIK 3

Përmirësimi i cilësisë së praktikës profesionale

Për t'u siguruar që të gjithë nxënësit e AAP marrin përfitimet maksimale nga përvoja e tyre në praktikën profesionale, janë disa faktorë që duhen shqyrtuar. Ndër to janë lidhjet mes punës dhe kurrikulumit, pritshmëritë e qarta nga aktiviteti i nxënësve në vendin e punës, role të

përcaktuara qartë të mësimdhënësve dhe mbikëqyrësve në vendin e punës, komente të strukturuar mirë rreth performancës së nxënësve dhe vlerësim i arritjes së shkathtësive. Ofrimi i trajnimit dhe asistencës teknike si për mësimdhënësit, ashtu edhe për personelin në vendin e punës është një aspekt me rëndësi për të krijuar një mjedis mikpritës dhe përkrahës ku nxënësit të kenë mundësinë të mësojnë.

MASAT

3.1 Të sigurohet se praktika profesionale e ofruar plotëson standardet e profesionit sipas kurrikulumit rishtazi të miratuar.

Niveli i lartë që ofrohet nga AAP është parakusht që AAP të jetë tërheqës. Me qëllim që të garantohet cilësia e përmirësuar, më shumë transparencë, besimi i ndërsjellë, mobiliteti për punëtorët dhe nxënësit e AAP si dhe mësimnxënie gjatë gjithë jetës, duhet të merren masa që e gjithë praktika profesionale të përmbush standardet e punës dhe kornizën e sigurimit të cilësisë sipas AKC. Përveç kësaj, duhen ndërmarrë veprime për të siguruar që kompetencat kyçe janë të integruara në kurrikulum dhe se janë zhvilluar mjetet e duhura për vlerësim.

Një pikë e mirë fillestare është puna në vijim e sipër që ka të bëjë me profilet e profesioneve në Qendrat e Kompetencës. Në bazë të kësaj përvoje dhe të mësimëve të nxjerra, atëherë procesi duhet që gradualisht të zgjerohet në profile të tjera nga rrjeti i shkollave AAP.

3.2 Të sigurohet se çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës si dhe me mbrojtjen e fëmijëve, respektohen gjatë aktiviteteve të praktikës profesionale.

Hapat paraprakë në këtë drejtim janë bërë nga disa projekte të financuara nga donatorët. Megjithatë, duhet bërë dhe një rivlerësim i gjendjes për të identifikuar zbrazëtitrat dhe për të bërë rekomandime për rishikimin ose kryerjen e dokumenteve aktualë. Megjithatë, vëmendja i duhet kushtuar dispozitave të ligjit në fuqi në lidhje me kushtet e posaçme që kërkohen nga punëtorë nën moshën 18 vjeçare, si dhe nga punëtorët me aftësi të kufizuara.

Duke qenë në dijeni të abuzimit në rritje të fëmijëve që mund të ndodhë në të gjitha aspektet e jetës së fëmijëve dhe të të rinjve, prindërit dhe kujdestarët gjithnjë e më shumë po bëhen syçelë. Kontrolli i vazhdueshëm i sjelljes së tyre përbën një sfidë profesionale për mësimdhënësit dhe mbikëqyrësit në vendin e punës. Është me rëndësi të mbahet mend se privilegji dhe përfitimet e shumta të ndërlidhura me punësimin në një rol që përfshin punën me fëmijë gjithashtu bartin edhe pritshmëri të standardeve më të larta dhe mbrojtje për ta.

3.3 Njohja e aftësive të arritura profesionale dhe sukseseve;

Për të motivuar dhe përkrahur nxënësit e AAP duhet të zhvillohet një kornizë për të vlerësuar arritjet personale në aspektin e njohurisë dhe shkathtësive teknike që bazohen në kritere objektive. Kjo kornizë duhet të lidhet specifikisht me praktikën e mësimnxënies personale që të rinjtë të përkrahen të vlerësojnë zhvillimin e tyre në kuptim të shkathtësive për mësimnxënie, shkathtësive për jetë dhe shkathtësive për punë. Shembuj se si mund të jepet ky vlerësim janë certifikatat dhe çmime në shkollë, tabelat e njoftimeve nëpër shkolla, portofolio *on-line* dhe ceremonitë e ndarjes së çmimeve.

3.4 Zhvillimi i një sistemi informativ efektiv në lidhje me vendet në dispozicion për praktikë profesionale;

Sikurse tregohet nga prioriteti strategjik AAP-1 në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011-2016 dhe në Ligjin e ri për Arsim dhe Aftësim Profesional, duhet të krijohet regjistri i ndërmarrjeve që marrin nxënës nga AAP-të për praktikë profesionale.

Duhet të përcaktohet struktura e këtij regjistri, rrjedha e informacionit dhe azhurnimet e vazhdueshme të tij. Për më tepër, nevojiten konsultime të tjera për të përcaktuar nëse ndërmarrjet pajtohen që në uebfaqen e MASHT-it të publikohet informacion i përzgjedhur nga ky regjistër për të rritur transparencën dhe shikueshmërinë publike. Kjo gjë mund të shihet edhe si mjet marketingu ose informacion shtesë lidhur me rekrutimin e punëtorëve të ardhshëm.

3.5 Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të drejtorëve dhe mësimitdhënësve të shkollave AAP dhe pajisja me materiale të përshtatshme mbështetëse për të themeluar partneritete të suksesshme me ndërmarrjet;

Edhe pse trajnimi fillestar i mësimitdhënësve dhe disa elemente të trajnimit të mëtjetshëm i kanë njohur shumë mësimitdhënës me konceptet e bashkëpunimit me ndërmarrjet, ende ekziston nevoja e madhe për t'iu ofruar atyre një perspektivë të mirinformuar mbi praktikatat dhe proceset moderne të punës. Edhe pse shkathtësitë teknike janë një element me rëndësi për AAP-të, ato duhet të ofrohen brenda një kornize që thekson se të gjitha shkathtësitë duhet të jenë të adaptueshme, në mënyrë që të rrisin shanset për punësim. Shkollat AAP duhet të inkurajohen të kërkojnë për diversitet në kontaktet e tyre me ndërmarrjet që të pasqyrojnë spektrin e plotë të aktivitetit ekonomik lokal sa më shumë që të jetë e mundur.

Prandaj, drejtorët e shkollave AAP dhe stafi i mësimitdhënies duhet të përkrahen nga të kuptuarit e një spektri më të gjerë të shkathtësive të ndërlidhura me punësimin. Këto mund të përfshijnë:

- Identifikimin e shkathtësive thelbësore që përdoren nga bizneset moderne - komunikimi, aftësia me numrat, leximi, puna në ekip, TI, njohuri komerciale;
- Theksi i vënë tek vlera e mësimitdhënies në bazë të përvojës dhe mësimitdhënies reflektive dhe mënyrat se si stafi dhe nxënësit mund ta adoptojnë këtë qasje në të gjithë elementët e zhvillimit të tyre personal;
- Zhvillimi i një kulture të trajnimit që përgatit për përshtatje dhe ndryshim, zhvillimi i shkathtësive personale për menaxhim të karrierës;
- Prezantimi i trajnimit të ndërlidhur me ndërmarrje tek të gjithë elementët e kurrikulumit për të përforcuar vetëdijen komerciale.

Modulet e trajnimit duhet të zhvillohen në lidhje me anëtarët e audiencës së synuar – drejtorët e shkollave AAP, personelin mësimitdhënës, përfaqësuesit e ndërmarrjeve dhe personelin nga inspeksioni. Trajnimi do të pasqyrojë përmbajtjen e moduleve me një sërë aktivitetesh të fokusuara tek reflektimi mbi përvojat nga puna në ndërmarrje dhe shqyrtimi i rasteve reale për studim.

PRIORITETI STRATEGJIK 4

Ofrimi i një kornize për punë të koordinuar mes akterëve vendorë që synon përmirësimin e praktikës profesionale nëpër ndërmarrje

Është me rëndësi për shkollat AAP të ndërtojnë partneritete të fuqishme me prindërit, bizneset dhe komunitetin. Është puna dhe përgjegjësia e të gjithëve që të sigurohen se nxënësit e AAP kanë mundësinë të zgjerojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre brenda një mjedisi praktik, në mënyrë që të jenë të përgatitur për punësim produktiv dhe mësimnxënie të mëtejshme.

MASAT

4.1 Informimi i gjerë mbi praktikat e mira mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve në lidhje me bashkëpunimin e suksesshëm në organizimin e praktikës profesionale;

Ekziston nevoja për rivlerësim të gjendjes, me qëllim që të mblidhen, të analizohen praktikat e mira dhe të zhvillohet një broshurë me to. Kjo do të përmbajë një përzgjedhje të përvojave frymëzuese të fituara deri më tani për t'ia vënë ato në dispozicion një audience më të gjerë (shkollave, punëdhënësve, organizatave punëmarrëse, komunave, agjencive rajonale për zhvillim, palëve të tjera të interesuara).

Ky aktivitet duhet të fokusohet në gjetjen e përgjigjeve të paktën për pyetjet në vijim:

- Cilat lloje të shkollave AAP kanë krijuar partneritete?
- Kush ka hyrë në partneritet me shkollat AAP?
- Cilat kanë qenë arsyt kryesore për të krijuar këtë partneritet?
- Çfarë provash janë përdorur për të identifikuar nevojat ose mundësitë e nxënësve?
- Si kanë kontribuar partnerët?
- Çfarë përfitimesh janë raportuar?
- Çfarë provash janë përdorur për të matur këto përfitime?

Sigurimi i mundësive për njerëzit që të takohen gjatë aktiviteteve vjetore për të ndarë përvojat e tyre ose dhe shqetësimet është një mjet i fuqishëm për të përforcuar bashkëpunimin mes ndërmarrjeve dhe partnerëve të tyre në arsim si dhe për të përfshirë gamën e nismave në të gjithë vendin.

4.2 Rritja e vetëdijësimit dhe fuqizimi i përkushtimit i të gjithë akterëve relevantë për përkrahjen e aktiviteteve të praktikës profesionale;

Shumë shpesh njerëzit kanë thënë “Nuk kam qenë i informuar” ose “Kurrë nuk e kam ditur se mund të marr pjesë në këtë proces” ose “Doja të përfshihesha, por nuk e dija nga t'ia filloja”. Prandaj, një fushatë e zbatuar mirë për ngritjen e vetëdijësimit, ku të përdoren instrumente të ndryshme si fletushka, reklama në mediat e shtypur ose audio-vizuale mund ta dërgojnë mesazhin e duhur tek audience e synuar dhe t'i bëjë ata të reagojnë.

4.3 Krijimi i partneriteteve mes sektorëve të arsimit dhe aftësisë formal dhe joformal, biznesit, akterëve vullnetarë dhe akterëve nga komuniteti në nivel rajonal dhe lokal;

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, në të gjithë botën është shtuar numri i formave të ndryshme të partneritetit mes partnerëve social, ndërmarrjeve, ofruesve të arsimit dhe të aftësisë, shërbimeve të punësimit, autoriteteve publike, organizatave kërkimore dhe palëve të tjera relevante të interesit, për të siguruar transferim më të mirë të informacionit rreth nevojave të

tregut të punës dhe për të siguruar një përputhje më të mirë mes atyre nevojave dhe zhvillimit të njohurisë, shkathtësive dhe kompetencave.

Megjithatë, rastet e studimit të kohëve të fundit tregojnë se efektet pozitive të atyre partneriteteve nuk janë të garantuara. Suksesi i partneriteteve të tilla kryesisht përcaktohet nga ajo se sa me kujdes janë planifikuar këto partneritete dhe me inputin e kujt. Ndaj duhet të hulumtohet se cili lloj i modelit për punë të koordinuar në nivel rajonal dhe lokal do të ishte i zbatueshëm në Kosovë, për të identifikuar se kush mund të jenë partnerët më relevantë dhe për të lehtësuar krijimin e këtyre partneriteteve.

6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe Vlerësimi luajnë një rol kritik në prodhimin e informacionit të nevojshëm për të përkrahur politikëbërjen e bazuar në dëshmi si dhe ndryshimet në rrjedhën e politikave. Monitorimi dhe Vlerësimi do të kryhen nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rritur ose ndonjë tjetër organ që do të caktohet¹.

Monitorimi i referohet procesit të mbledhjes dhe të analizimit sistematik të të dhënave mbi indikatorë specifik për të gjeneruar informacion mbi progresin dhe arritjen e një prioriteti të caktuar strategjik, për të përkrahur vendimmarrje efektive.

Matrica e Planit të Veprimit ofron bazë të shëndoshë për këtë aktivitet. Deklaratat për prioritetin strategjik pasqyrojnë një gjendje përfundimtare, ndërsa indikatorët e ndërlidhur me rezultatin janë indikatorë kyç të performancës. Që të dy janë përshkrues—të përshtatshëm. Të dhënat do të raportohen çdo tre muaj nga shkollat AAP për Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional të të Rriturve ose ndonjë organ tjetër që do të caktohet.

Mjetet kyçe që do të përdoren për të bërë këto vlerësime dhe që përkrahin menaxhimin dhe monitorimin efektiv gjatë fazës së implementimit përfshijnë kritere të cilësisë dhe standarde, matricën e Planit të Veprimit, afatet e programit të aktivitetit/punës dhe tabelat e burimeve/buxhetit, listat për planifikimin e vizitave të shkurtra, zhvillimin e intervistave dhe menaxhimin e takimeve të rregullta rishikuese si dhe një sërë instrumentash specifike për të mbledhur të dhëna kuantitative dhe kualitative.

Çdo gjashtë muaj, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rritur do të dorëzojë një raport të progresit pranë Departamentit të Arsimit Para-universitar dhe Këshillit për Aftësim dhe Arsim Profesional dhe Arsim dhe Aftësim për të Rritur.

Vlerësimi është analizim periodik i rëndësisë dhe përmbushjes së prioritetëve strategjike, të zhvillimit të efikasitetit, efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë.

Implementimi i strategjisë do të vlerësohet çdo vit nga Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional kundrejt indikatorëve kyç të performancës dhe synimeve. Gjetjet do t'i raportohen Drejtorit të Departamentit të Arsimit Para-universitar dhe Ministrisë. Plani i Veprimit do të azhurnohet çdo vit për të zgjeruar ato që funksionojnë dhe ndryshuar ato që nuk funksionojnë.

Mjetet parësore në dispozicion për të përkrahur strategjinë e vlerësimit përfshijnë matricën e Planit të Veprimit, raportet tremujore të monitorimit dhe Planet Vjetore të azhurnuara.

¹ Për shembull, Zyra për Bashkëpunim Ekonomik në Arsim dhe Aftësim Profesional

7. IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË

Koordinatori për Praktikë Profesionale siguron lidhjen mes nxënësit të AAP, shkollës AAP, Zyrës për Bashkëpunim Ekonomik në Arsimim dhe Aftësim Profesional (OECVET) dhe punëdhënësit. Çdo mësimdhënës/praktikues në profesion përkatës duhet të marrë përsipër rolin e Koordinatorit të praktikës profesionale.

Menaxhmenti i shkollës AAP ka rolin kryesor në organizimin e programeve të praktikës profesionale. Prandaj, Koordinatorët e praktikës profesionale dhe drejtorët e shkollave AAP duhet të kërkojnë mundësitë për të zhvilluar partneritete në fusha më të gjera brenda rrjeteve lokale, të mbështesin punëdhënësit në ofrimin e praktikës profesionale për nxënësit të një cilësie sa më të lartë. Puna e OECVET dhe DKA-ve mund të jetë e dobishme si pikë fillestare duke ndihmuar në zhvillimin e partneriteteve shkollë AAP-ndërmarrje.

Roli i **Punëdhënësit** në realizimin e suksesshëm të programit të praktikës profesionale nuk duhet të nënvlerësohet. Përgjegjësia e tij kryesore është të sigurojë që nxënësit AAP të aftësohen dhe të fitojnë përvojën praktike elementare në lidhje me profilin profesional. Ai duhet të sigurojë një vlerësim përfundimtar të performancës së nxënësve AAP bazuar në kriteret e dhëna në rregullat për praktikën profesionale.

Prindërit mund të ndajnë përvojat e tyre të punës me nxënësit dhe të diskutojnë për ndonjë pasiguri që nxënësi mund të ketë. Ata duhet të diskutojnë aktivitetet e ditës me nxënësit, dhe, nëse është identifikuar ndonjë problem, të inkurajojnë nxënësit të ndjekin procedurat e drejta për t'u marrë me atë problem. Prindërit gjithashtu duhet të diskutojnë vendosjen e nxënësit dhe të sigurojnë që nxënësi ka shprehë mjaftueshëm përvojat e tij/saj në vendin e punës.

Roli parësor i **Zyrës për Bashkëpunim Ekonomik në Arsimin dhe Aftësimin Profesional** (OECVET) është koordinimi në mes të industrisë dhe shkollave për të siguruar vende të reja për praktikë profesionale. Nga OECVET kërkohet të punojë në konsultim me industrinë, me shkollat AAP, OEK, DKA-të, QRP/ZKP, AZhR, OJQ, për të identifikuar vendet e përshtatshme për praktikë profesionale, sidomos në ato fusha të industrisë me rezultate të larta profesionale si dhe të lehtësojë dhe koordinojë qasjen në këto vende për nxënësit e AAP.

Në mënyrë që Drejtorët e Shkollave AAP dhe Koordinatorët për Praktikë Profesionale të zhvillojnë dhe menaxhojnë me efektivitet programe të praktikës profesionale, **Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional për të Rriturit** (AVETA) duhet të sigurojë se ata kanë njohuritë e duhura dhe shkathtësitë menaxhuese për të themeluar partneritete të suksesshme mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve. Për më tepër, AVETA duhet të vë në dispozicion udhëzuesit përkatës dhe procedurat për të organizuar praktikën profesionale, duke iu ndihmuar me materiale të duhura përkrahëse (broshura, fletëpalosje, doracak, shabllone, forma, modele të kontratave etj.), duke u siguruar se në të gjithë vendin veprohet njësoj, me krahasueshmëri dhe cilësi të lartë të programeve të praktikës profesionale.

Roli i **Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim dhe Aftësim për të Rritur** është të përkrahë zhvillimin e një partneriteti social në të gjitha aspektet e AAP, duke siguruar kështu lidhje mes arsimit, aftësimin dhe punës në kuptim të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Si këshilltar kryesor për politikë për MASHT, CVETAET duhet të bëjë propozimet e duhura për mekanizma nxitës për të përkrahur si nxënësit e AAP ashtu dhe punëdhënësit gjatë praktikës profesionale.

8. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit në Shtojcën 'A' përshkruan programin e aktivitetit për të implementuar këtë strategji dhe burimet që kërkohen për ta përkrahur atë. Zbatimi i planit kërkon përpjekje nga të gjithë organizatat partnere shoqërore dhe nga fuqia punëtore e parashtruar në Planin e Implementimit.

Partnerët e tjerë, duke përfshirë projektet aktuale ose të ardhshme të donatorëve gjithashtu pritet të ofrojnë përkrahje për zbatimin e strategjisë përmes aktiviteteve të tyre të vazhdueshme me palët e interesit në të gjithë sektorin.

Prioritetet strategjike	Masat	Veprimet	Indikatorët e performancës	Afati kohor	Përgjegjësitë	
1. Rritja e numrit të punëdhënësve që ofrojnë vende/mundësi për praktikë profesionale Indikatori bazë: Në vitin 2012, nuk ka dëshmi se në ndërmarrje është ofruar praktikë profesionale cilësore për nxënësit e AAP Indikatori i synuar: Deri më 2020 të krijohet partneritet me së paku 1500 ndërmarrje të cilat ofrojnë vende/mundësi për praktikë profesionale cilësore për nxënësit e APP	1.1 Lehtësime për punëdhënësit të marrin përsipër praktikën profesionale duke iu prezantuar materiale udhëzuese për punëdhënësit dhe duke e thjeshtësuar procesin	1.1.1 Zhvillimi i doracakut për punëdhënësit	Doracakut për punëdhënësit i zhvilluar (me kritere të themeluara dhe të detajizuara)	T2 2014 – T4 2020	MASHT Shkollat AAP	
		1.1.2 Zhvillimi i udhëzuesëve për punëdhënësit	Udhëzuesi i zhvilluar për punëdhënësit			
		1.1.3 Vënia në dispozicion të doracakut dhe udhëzuesit për ata punëdhënësit që kanë nënshkruar marrëveshje partneriteti	Numri i punëdhënësve që kanë pranuar Doracakun dhe udhëzuesin për punëdhënësit			
	1.2 Mbeshtetja e punëdhënësve për të pranuar nxënësit për praktike profesionale nëpërmjet mekanizmave stimules	1.2.1 Të bëhet studim fizibiliteti (i realizueshëm) për krijimin e modelit si mekanizma stimules (në përputhshmëri me ligjin e AAP-ve)	Studimi i fizibilitetit i realizuar	Korniza e re ligjore është zhvilluar	T4 2014 - T2 2015	MASHT MAPL MF DKA-të
		1.2.2 Nëse i realizueshëm të krijohet një kornizë e re ligjore për mekanizmat stimules	Korniza e re ligjore është dorëzuar për miratim			
		1.2.3 Prezentimi/ofrimi i propozimeve për mekanizëm nxitës/stimules tek autoriteti gjegjës vendimmarrës				
	1.3 Promovimi i njohjes, vlerës dhe punës së punëdhënësve që kanë ofruar mundësi për praktikë profesionale	1.3.1 Themelimi i kritereve për shpërblimin e punëdhënësve	Pakoja e kritereve për të cilat është rënë dakord	Zhvillimi i instrumentave shpërblyes	T4 2014 - T4 2020	MASHT OEK
		1.3.2 Zhvillimi i instrumentave shpërblyes	Numri i ceremonive të organizuara; Numri i punëdhënësve që janë shpërblyer; Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë në ceremony			
		1.3.3 Organizimi i ceremonive vjetore shpërblyes				
	1.4 Praktika profesionale të bëhet më e kuptueshme për punëdhënësit	1.4.1 Zhvillimi i materialeve promovuese për të shpejguar qëllimin, rolin dhe përgjegjësitë e punëdhënësve që përkrahin praktikën profesionale	Numri i materialeve që janë krijuar	Numri i punëdhënësve që kanë pranuar materiale promovuese	T4 2014 - T4 2020	MASHT OEK
		1.4.2 Shpërndarja e materialeve promovuese tek punëdhënësit përkrahës				

		1.4.3 Organizimi i takimeve rajonale me punëdhënës për të promovuar nevojën për përkrahje të praktikës profesionale	Numri i mbledhjeve rajonale që janë organizuar; Numri i punëdhënësve që kanë marrë pjesë në këto ngjarje		
2. Rritja e numrit të nxënësve AAP që marrin pjesë në praktikë profesionale Indikatori bazë: Në vitin 2012 nuk ka deshmi qe siguron se vijimi i praktikës profesionale nga nxënësit e AAP ne ndermarrje, ka qene cilësor Indikatori i synuar: Deri më 2020 se paku 10,000 nxënësve të AAP do të ju ofrohet praktikë profesionale cilësor ne ndermarrje private dhe institucione	2.1 Të bëhet e sigurtë se praktika profesionale në tërësi i përshtatet kërkesave dhe aftësive individuale të secilit nxënës të AAP	2.1.1 Zhvillimi i instrumentave për analizimin e nevojave individuale për nxënës të AAP	Numri i instrumentave që janë zhvilluar	T2 2014 - T3 2014	MASHT MPMS DKA-të Shkollat AAP
		2.1.2 Identifikimi i nevojave individuale të nxënësve të AAP	Nevojat individuale të nxënësve AAP janë identifikuar		
		2.1.3 Ndërmarrja e veprimeve të duhura për të plotësuar nevojat e identifikuar	Numri i veprimeve të duhura që janë ndërmarrë		
	2.2 Të sigurohen fonde shtesë për nxënësit e kualifikuar të AAP-ve	2.2.1 Përcaktimi i kategorive të nxënësve AAP që kanë të drejtë të marrin përkrahje financiare	Pakoja e kriterëve për të cilat është arritur pajtimi	T4 2014 - T2 2015	MASHT MAPL MF DKA-të
		2.2.2 Zhvillimi i modelit financiar për mekanizmin e përkrahjes financiare	Modeli financiar është zhvilluar		
		2.2.3 Zhvillimi i kornizës së re ligjore për mekanizmin e përkrahjes financiare	Korniza e re ligjore është zhvilluar		
		2.2.4 Prezentimi i propozimeve për mekanizmin e përkrahjes financiare tek organi i duhur vendimmarrës	Korniza e re ligjore është dorëzuar për miratim		
	2.3 Komunikimi i përfitimeve nga praktika profesionale tek nxënësit AAP dhe prindërit e tyre	2.3.1 Zhvillimi i materialeve promovuese	Numri i materialeve promovuese që është zhvilluar	T4 2014 - T4 2020	MASHT DKA-të Shkollat AAP
		2.3.2 Shpërndarja e materialeve promovuese tek prindërit	Numri i prindërve që kanë pranuar materialet promovuese		
		2.3.3 Organizimi i takimeve me prindër	Numri i mbledhjeve të organizuara; Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë në mbledhje		
3. Përmirësimi i cilësisë së praktikës profesionale Indikatori bazë: Në vitin 2012 cilësia e mekanizmave ekzistues për	3.1 Të sigurohet se praktika profesionale e ofruar plotëson standardet e profesionit sipas kurrikulumit rishtazi të miratuar;	3.1.1 Analizimi i programit aktual të praktikës profesionale kundrejt standardeve të profesionit	Numri i programeve të praktikës profesionale që janë analizuar	T2 2014 - T4 2016	MASHT Shkollat AAP
		3.1.2 Konsultime me punëdhënës përkatës	Numri i mbledhjeve konsultative që janë organizuar; Numri i punëdhënësve që marrin pjesë nëpër mbledhje		

<p>përshtatjen e AAP me kërkesat e ndryshueshme të tregut të punës është vlerësuar e ulët</p> <p>Indikatori i synuar: Deri më 2016 programet e praktikës profesionale do të jenë 60% në përputhje me standardet e profesioneve dhe të gjithë mësimdhënësit relevant kanë shkathhtësitë e nevojshme për të themeluar partneritete të suksesshme</p>		3.1.3 Plotësimi i programeve të praktikës profesionale kundrejt standardeve të profesionit	Numri i programeve të praktikës profesionale që janë rishikuar		
	3.2 Të sigurohet se çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës si dhe mbrojtjen e fëmijëve, respektohen gjatë aktiviteteve të praktikës profesionale	3.2.1 Zhvillimi i doracakut për sigurinë dhe shëndetin në punë	Doracaku për siguri dhe shëndet në punë është zhvilluar	T3 2014 - T4 2014	MASHT Shkollat AAP
		3.2.2 Zhvillimi i doracakut për mbrojtjen e fëmijëve	Doracaku për mbrojtjen e fëmijëve është zhvilluar		
		3.2.3 Shpërndarja e të dy doracakëve nëpër shkollat AAP	Numri i shkollave AAP që kanë pranuar të dy doracakët		
	3.3 Njohja e aftësive të arritura profesionale dhe sukseseve	3.3.1 Themelimi i kriterëve për certifikimin e arritjeve të aftësisë profesionale gjatë praktikës profesionale	Pakoja e kriterëve për të cilat është arritur pajtimi	T3 2014 - T3 2016	MASHT DKA-të Shkollat AAP
		3.3.2 Zhvillimi i instrumentëve certifikuese	Instrumentet shpërblyese që janë zhvilluar		
	3.4 Zhvillimi i një sistemi informativ efektiv në lidhje me vendet në dispozicion për praktikë profesionale	3.4.1 Krijimi i regjistrit kombëtar të ndërmarrjeve që ofrojnë praktikë profesionale	Regjistri kombëtar është zhvilluar	T2 2014 - T4 2016	MASHT Shkollat AAP
		3.4.2 Azhurnimi i rregullt i regjistrit	Numri i azhurnimeve të regjistrit		
		3.4.3 Publikimi i regjistrit në uebfaqen e MASHT	Regjistri i publikuar në uebfaqen e MASHT		
	3.5 Ngritja e njohurive dhe shkathhtësive të drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave AAP dhe pajisja me materiale të përshtatshme mbështetëse për të themeluar partneritete të suksesshme me ndërmarrjet	3.5.1 Të planifikohet një program trajnues për mësimdhënës për punë me ndërmarrjet	Programi për trajnimin e mësimdhënësve është planifikuar	T3 2014 - T4 2020	MASHT Shkollat AAP
		3.5.2 Zhvillimi i doracakut për mësimdhënës mbi praktikën profesionale	Doracaku për mësimdhënës mbi praktikën profesionale është zhvilluar		
		3.5.3 Mbajtja e programit trajnues për mësimdhënës	Numri i sesioneve për aftësim të mësimdhënësve që janë mbajtur; Numri i mësimdhënësve që janë trajnuar; Numri i partneritetve të reja të themeluara me ndërmarrjet		

4. Ofrimi i një kornize për punë të koordinuar mes akterëve vendorë që synon përmirësimin e praktikës profesionale nëpër ndërmarrje Indikator bazë: Në vitin 2012 asnjë nga shkollat e AAP nuk kanë qenë partnere në partneritete lokale të themeluara zyrtarisht Indikator i synuar: Deri më 2016 së paku 80% e shkollave të AAP të jenë partnere në partneritete lokale të themeluara zyrtarisht	4.1 Informim i gjerë mbi praktikën e mira mes shkollave AAP dhe ndërmarrjeve në lidhje me bashkëpunimin e suksesshëm në organizimin e praktikës profesionale	4.1.1 Mbledhja, analizimi dhe zhvillimi i broshurës me përvoja të mira nga praktika	Broshura për praktika të mira është krijuar	T3 2014 - T3 2016	MASHT Shkollat AAP	
		4.1.2 Organizimi i shpërndarjes së informatave në gjysëm vjetor si	Numri i ngjarjeve për informim që janë organizuar; Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë në ngjarjet për informim			
	4.2 Rritja e vetëdijësimit dhe fuqizimi i përkushtimit të gjithë akterëve relevantë për përkrahjen e aktivitetëve të praktikës profesionale	4.2.1 Planifikimi i fushatës së vetëdijësimit	Fushata për vetëdijësim është planifikuar	Numri i ngjarjeve për ngritje të vetëdijësimit që janë zhvilluar; Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë në ngjarjet për ngritje të vetëdijësimit	T3 2014 - T4 2014	MASHT
		4.2.2 Zhvillimi i instrumentave për fushatën e vetëdijësimit	Numri i instrumentave që janë zhvilluar			
		4.2.3 Implementimi i fushatës së vetëdijësimit				
	4.3 Krijimi i partneriteteve mes sektorëve të arsimit dhe aftësisimit formal dhe joformal, biznesit, akterëve vullnetarë, dhe akterëve nga komuniteti në nivel rajonal dhe lokal	4.3.1 Zhvillimi i modelit për punë të koordinuar në nivel rajonal dhe lokal	Modeli për punë të koordinuar është zhvilluar	Partnerët lokalë janë identifikuar; Informacionet e kërkuara janë mbledhur	T2 2014 - T4 2014	MASHT DKA-të Shkollat AAP MPMS AZHR
		4.3.2 Identifikimi i partnerëve lokalë dhe mbledhja e informacioneve				
		4.3.3 Lehtësime gjatë themelimit të partneriteteve rajonale dhe lokale	Numri i takimeve që janë organizuar; Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë në takime; Numri i partneriteteve që janë themeluar			